

Në bazë të nenit 14 , paragrafi 1, pika 8.3 të Statutit të Universitetit të Evropës Juglindore, Bordi i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 07.06.2011 miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E POLITIKAVE TË UNIVERSITETIT PËR PROGRAMIN PUNË – STUDIM**

### *Neni 1*

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet me të cilat studentët mund të përfitojnë nga programi punë-studim në përputhje me politikat financiare të universitetit.

Programi për mbështetje financiare punë-studim për çdo vit akademik alokohet në buxhetin e universitetit në përputhje me dispozitat buxhetore.

### *Neni 2*

Si pjesë e pakos për ndihmë financiare universiteti u ofron studentëve mundësi për angazhim në Programin punë-studim sipas kushteve të mëposhtme:

- paga e studentit nuk mund të tejkalojë koston e pagesës së shkollimit për vit;
- studentëve të angazhuar në këtë program u lejohe të punojnë më së shumti 15 orë në javë;
- përzgjedhja e studentëve bëhet në bazë të nevojës për ndihmë financiare dhe të aftësive për vendin e punësë
- konflikti i interesit duhet të deklarohet paraprakisht dhe mund të ndikojë në punësim.

### *Neni 3*

Të drejtë aplikimi në këtë program kanë të gjithë studentët që ndjekin studimet e rregullta në UEJL.

### *Neni 4*

Studentët nuk kanë të drejtë të angazhohen dy vite radhazi në këtë program. Përjashtim mund të bëhet vetëm në rastet kur përgjegjësi i departamenti vlerëson se studenti i angazhuar në vitin paraprak ka treguar performansa të jashtëzakonshme dhe arsyeton nevojën për vazhdim, në pajtim me Nenin 2.

### *Neni 5*

Studentët që kanë pranuar bursë apo ndihmë financiare nga cilido fond në vitin paraprak ose e pranojnë atë në vitin vijues akademik nuk lejohen të punojnë në të njëjtin vit akademik.

### *Neni 6*

Studentët që dëshirojnë të përfitojnë nga kjo mundësi duhet të plotësojnë aplikacionet të cilat mund të merren në Zyrën për ndihmë financiare. Kjo zyrë është përgjegjëse për njoftimin e vendeve të lira të punës si dhe për përpunimin dhe shqyrtimin e kërkesave.

Pas përpunimit dhe shqyrtimit të kërkesave, studentët i nënshtrohen edhe procesit të intervistimit dhe të testimit nga përfaqësuesit e departamenteve ku kanë aplikuar.

Seksioni, departamenti ose zyra që ka nevojë për një vend do ta thotë fjalën e fundit për angazhimin në punë të studentëve.

Studenti i cili nuk është pranuar mund të ankohet me shkrim deri tek drejtori i shërbimit të studentëve i cili mund pas kësaj të kërkoj rishqyrtim të vendimit.

### *Neni 7*

Përfaqësuesit e departamenteve janë të obliguar të mbajnë evidencë për angazhimin e studentëve në punë dhe në raport mujor t'i raportojnë orët e punës Zyrës për ndihma financiare. Ato gjithashtu sigurojnë raport për performancën e studentit pas gjashtë muajve dhe raport përfundimtar/ referencë pasi studentit të ketë përfunduar me angazhimin.

### *Neni 8*

Zyra për ndihma financiare obligohet që pas mbarimit të angazhimit në punë t'i informojë studentët nëpërmjet raporteve për shumën e mjeteve që kanë përfituar si rezultat i punës së kryer.

### *Neni 9*

Kjo rregullore hyn në fuqi nga 01.09.2011